

V E N D I M
Nr.694, datë 21.10.1996

**PËR NORMËN MËSIMORE E SHKENCORE NË SHKOLLAT E LARTA DHE NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR, PAGIMIN E ORËVE SUPLEMENTARE, AKTIVIZIMIN E
PENSIONISTËVE DHE PUNONJËSVE TË JASHTËM NË SISTEMIN E ARSIMIT**

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit të Lartë dhe të Kërkimeve Shkencore dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Norma mësimore-shkencore në shkollat e larta të jetë në kompetencë të Ministrisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore, kurse norma mësimore në arsimin parauniversitar të jetë në kompetencë të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

2. Punonjësit e jashtëm, të punësuar në sektorin buxhetor për nevoja pune, lejohen të japin deri në 8 orë mësimi në javë, plus orët e provimeve.

Punonjësit e jashtëm, të punësuar në sektorin jobuxhetor dhe pensionistët mund të aktivizohen me të drejtë page deri në 10 orë mësimi në javë, plus orët e provimeve.

3. Tarifa e orës mësimore suplementare të jetë:

- Në shkollat e larta 210 lek/ora
- Në shkollat e mesme 120 lek/ora
- Në shkollat 8-vjeçare 100 lek/ora

4. Mësuesit me arsimin përkatës në arsimin parauniversitar dhe pedagogët e shkollave të larta lejohen të japin orë mësimore mbi normën e miratuar sipas nevojave të shkollës.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.460, datë 23.12.1991; vendimi nr.494, datë 18.9.1995 dhe në vendimin nr.615, datë 31.12.1993 në pikën 1, shkronjat d, e, f, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 tetor 1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi